

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GREEN MINERALS" shpk

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Bazuar ne ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 i ndryshuar si dhe akteve nenligjore ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare "si dhe te ligjit Nr 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit " i ndryshuar ne fuqi si dhe te te gjitha akteve nenligjore ne fuqi si dhe te te gjitha akteve ligjore te legjislacionit shqiptare ne fuqi

Vendosi si me poshte :

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1) Sot, më 24 Janar 2023 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**GREEN MINERALS**" shpk.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
 - a) **Mehmet Muja** atësia Ali shtetas Shqiptare identifikuar me anë të pasaportës me numër BD9004245 me numër personal identifikimi I40515034R i datëlindjes 15.05.1984 lindur në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi dhe banues në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - b) **Sahit Muja** atësia Ali shtetas Shqiptare identifikuar me anë të pasaportës me numër BD9940013 me numër personal identifikimi H00107027A i datëlindjes 07.01.1970 lindur në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi dhe banues në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - c) **Elez Muja** atësia Ali shtetas Shqiptare identifikuar me anë të pasaportës me numër BO1084018 me numër personal identifikimi G70325241L i datëlindjes 25.03.1967 . lindur në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi dhe banues në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - d) **Hazir Muja** atësia Ali shtetas Shqiptare identifikuar me anë të pasaportës me numër BE3126522 me numër personal identifikimi H80605034T i datëlindjes 05.06.1978 . lindur në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi dhe banues në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Shqiperi madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2:

Objekti

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Ne fushen e kerkim-zbulimit Nxerrjes dhe shfrytezimit Perpunimit dhe tregtimit Eksport-Importit te gjitha mineralave metalore dhe jo metalore e tjer .
 - b) Ne fushen e ndertimit dhe te rindertimit te objekteve dhe ndertesave te ndryshme civile industriale dhe infrastrukturore te gjitha llojeve e tjer .
 - c) Tregtimit dhe importit dhe eksportit te gjitha produkteve mallrave dhe sherbimit pa kufizim
 - d) Ne fushen e te gjitha sherbimeve te ndryshme civile dhe tregtare te sigurimit mbeshtetjes financimit konsulences ligjore tekniko-profesionale te te gjitha fushave e tjer qe ofron dhe kerkon tregu shqiptare dhe mundeson legjislacioni ne fuqi dhe ne vazhdim .
 - e) Ne fushen e prodhimit perpunimit ruajtjes dhe tregtimit si dhe eksport -importit te te gjitha produkteve bujqesore blegtoreale mjeksore dhe farmacuetike e tjer pa kufizim sic e lejon dhe parashikon legjislacioni shqiptare ne fuqi dhe ne vazhdim .
 - f) Ne fushen e Turizmit te te gjitha llojeve dhe mundesive qe ofron tregu vendas dhe kerkon tregu i jashtem e tjer pa kufizime sipas legjilacionit ne fuqi dhe ndryshimet qe mund te pesoje

Neni 3:
Kohëzgjatja

Faqe 1 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

shpk



1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:

Selia

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rezidencen banese private tre kateshe ne Fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Qarku Kukës Shqiperi
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000000 (Nje miliarde) Lekë ne natyre dhe është i ndarë në 100 (Njeqind) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Mehmet Muja zotërues i 25 (Njezete e pese) kuota me vlerë të përgjithshme 250000000 (Dyqind e pesedhjete miljon) Lekë, që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Sahit Muja zotërues i 25 (Njezete e pese) kuota me vlerë të përgjithshme 250000000 (Dyqind e pesedhjete miljon) Lekë, ne natyre që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - c) Ortaku themelues Elez Muja zotërues i 25 (Njezete e pese) kuota me vlerë të përgjithshme 250000000 (Dyqind e pesedhjete miljon) Lekë, ne natyre që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - d) Ortaku themelues Hazir Muja zotërues i 25 (Njezete e pese) kuota me vlerë të përgjithshme 250000000 (Dyqind e pesedhjete miljon) Lekë, ne natyre që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejtë).

Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Faqe 2 e 7
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
_____ shpk



KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve të përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zgoglimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jetet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dérgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar përmblidhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuromi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përmblidhje.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Faqe 3 e 7
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
_____ shpk



Neni 11
Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Mehmet Muja atësia Ali shtetas shqiptare identifikuar me anë të pasaportës me numër BD9004245 me numër personal identifikimi I40515034R i datëlindjes 15.05.1984 lindur në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Qarku Kukes Shqiperi dhe banues në fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Qarku Kukes Shqiperi me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administratorit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruanjë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmiratim, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

Faqe 4 e 7
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

shpk



- g) raportojnë përparras asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asambleën e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15
Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuar nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarë së shoqërisë në mëdjes;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, përfshirë të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përfashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës përfshirë të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese përfshirë detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë përfshirë detyrimet që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Faqe 5 e 7
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
_____ shpk

- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV
VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 16
Viti Financiar

- 1) Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17
Eksperet

- 1) Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij përrastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë përrastet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'jua paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

KREU V
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18
Prishja dhe likuidimi


- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë se Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizimi i shoqërlsë, bashkimi, ndarja

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20
Baza Ligjore

Faqe 6 e 7
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
_____ shpk



- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 21
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

O R T A K È T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GREEN MINERALS" shpk


1 .Ortak Themelues dhe ADMINISTRATORE DHE PERFAQESUES LIGJORE i shoqerise

Mehmet Muja


Mehmet Muja 

2 .Ortak Themelues
Sahit Muja

Sahit Muja



3 . Ortak Themelues
Elez Muja

Elez Muja 

4 . Ortak themelues
Hazir Muja

Hazir Muja 

Faqe 7 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
shpk